



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 13.01.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 04.01.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “**Adnan A. Bala B.I.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “**Ri Tender Blerja e aparaturave mjekësore (KPSH, stomatologji dhe laborator) dhe jo mjekësore**”, Nr. i prokurimit- 632-21-8240-1-2-1, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “**Adnan A. Bala B.I.**”, e dt.04.01.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ri Tender Blerja e aparaturave mjekësore (KPSH, stomatologji dhe laborator) dhe jo mjekësore**”, Nr. i prokurimit- 632-21-8240-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-21-055-121., kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 30.12.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë 30.12.2021;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

Ar sy e t i m

Me dt.04.01.2022, Operatori Ekonomik “Adnan A. Bala B.I., kaparashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: **Ri Tender Blerja e aparaturave mjekësore (KPSH, stomatologji dhe laborator) dhe jo mjekësore**“, Nr. i prokurimit- 632-21-8240-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-21-055-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 13.01.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Ju si Operator ekonomik, keni ofertuar në platformën elektronike si Operator i vetëm ekonomik, kurse brenda ofertës keni marrëveshjen e konzorciumit me Operatorin ekonomik ”Dona Dent”.

Ne këtë mënyre nuk e keni plotësuar kërkesën e Dosjes se Tenderit:

Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	11.1	<p>a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës;</p> <p>b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;</p> <p>c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit; dhe</p> <p>d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.</p> <p>e. <u>Të gjithë Operatorët Ekonomik që ofertojnë, qoftë individualisht, apo si grup i operatorëve ekonomik duhet të jenë të regjistruar në platformën e sistemit të e-prokurimit</u></p>
---	------	---

-Pas konsultave me personelin e KPSH-së, Njësia e kërkesës ka ardhë ne përfundim që specifikacioni duhet te përmirësohet si vijon:

1. Për shkak se shefi i stomatologjisë nuk ka pas aprovim nga Drejtori i DSHMS-se për hapjen e një sektori te ri kirurgjikal i cili shkel statusin e KPSH-se nuk mund te blihen këto pajisje.
2. Loti I -pika 8,9 e 10 nuk hynë nga blerjet me mjete te destinuara për investime kapitale , te njëjtat mund te blihen si barna emergjente nga mallrat dhe shërbimet.

3. Loti II - pika 1,5,6,7,8,9,10,11 e 12 nuk blihen nga mjetet e destinuar për investime kapitale, te njëjtat(uniforma pune) duhet te blihen nga mallrat dhe shërbimet. po ashtu edhe pika 3 është material shpenzues i cili duhet te sigurohet nga mallrat dhe shërbimet.
4. Specifikacioni i blerjes se pajisjeve mjekësore për laborator biokimik-hematologjik nuk mund te blihet nga investimet kapitale sepse blerja e reagensëve duhet te sigurohen nga mallrat dhe shërbimet me ç'rast kërkohet qe edhe pajisjet te sigurohen nga kompania e cila bene furnizimin me reagensa gjë qe kjo blerje po ashtu behet nga mallrat dhe shërbimet.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës